



REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPK</u>	Nr Prot. <u>03-02/4603/16</u>
Dep. <u>DPK</u>	Br Prot. <u>03-02/4603/16</u>
Nr. lfaq	Prot No. <u>03-02/4603/16</u>
Broj stranica <u>02</u>	Data <u>09.12.2016</u>
Nr. pages	Datum <u>09.12.2016</u>
	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.12.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3390/16, për zyrtarin e lartë z. Naser Peci, Dekan i Fakultetit të Gjeoshkencës në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mospajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3390/16, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Naser Peci, Dekan i Fakultetit të Gjeoshkencës në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë z. Naser Peci, Dekan i Fakultetit të Gjeoshkencës në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”, figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z.Naser Peci, ka ardhur ne zyrat e AKK-së, për tu njoftuar për situatën dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

z. Peci, gjatë këtij takimi është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se në biznesin në fjalë ka mbetur i regjistruar si person i autorizuar, por ka theksuar se do ti ndërmarr të gjitha hapat duke kontaktuar me pronaret e këtij biznesi pasi qe gjinden jashtë vendit dhe brenda afatit ligjor do të sjell dëshminë qe në biznesin ne fjalë nuk do të ushtroj funksion menaxherial dhe do të heq dorë nga e drejta e ushtrimit të funksionit si person i autorizuar në këtë biznes.

Pas këtij takimi z. Naser Peci, na ka dërguar, dëshminë se ka dhen dorëheqje nga funksioni i personit të autorizuar ne biznesin në fjalë, dhe na ka njoftuar se mbetet nga pronarët qe ta largojnë edhe zyrtarisht si person i autorizuar i këtij biznesi.

Duke parë qe kjo procedurë po vonohet Agjencia kundër Korrupsionit i ka dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese, ku e ka paralajmëruar zyrtarin z. Naser Peci, se nëse nuk ndërmerrni të gjitha hapat për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të paraparë, Agjencia është e obliguar te veproj konform nenit 18 (paragrafi 8) te Ligjit Nr.04/L- 051.

Me datën 07.12.2016 nga zyrtari i lartë z. Naser Peci, kemi pranuar dokumentin zyrtarë të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se ne biznesin me emër “E&E Experts” L.L.C me nr.71092690 zyrtari i lartë z. Naser Peci, nuk figuron me si person i autorizuar në këtë biznes.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Naser Peci, Dekan i Fakultetit të Gjeoshkencës në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” janë krijuar rrethana të reja dhe konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mospajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

